

UDHËZIME PËR RINOVIMIN

- Hapi 1 Përgjigjuni të gjitha pyetjeve në formularin e rinovimit (MAP-909e). Nëse në udhëzime ju thuhet se duhet të jepni prova, shihni pjesën e poshtme dhe të pasme të kësaj faqeje për një listë se çfarë mund të përdorni si provë.
- Hapi 2 **Formulari i ruajtjes financiare në rinovim**, në faqen 8 të formularit **Njoftimi i rinovimit** (MAP-909e) nevojitet vetëm nëse pjesa juaj e shpenzimeve mujore për strehimin është më shumë se 70% e të ardhurave mujore bruto.
- Hapi 3 Nëse jeni të regjistruar në një plan kujdesi shëndetësor afatgjatë të menaxhuar, kontaktoni planin nëse keni nevojë për ndihmë që të plotësoni formularin e rinovimit.
- Hapi 4 Nëse keni një bashkëshort/e që nuk aplikon për Medicaid, plotësoni dhe nënshkruani MAP-3179a (AL) Autorizim për verifikim të burimeve (bashkëshorti/ja ligjore).
- Hapi 5 Na dërgoni formularin tuaj të plotësuar të **Rinovimit**, MAP-3179a (AL) Autorizimin për verifikimin e burimeve (bashkëshorti/ja ligjore) dhe provat duke përdorur zarfin e përfshirë me postë të paguar. Ju lutemi të përgjigjeni para datës së printuar në faqen 1 të formularit të rinovimit (MAP-909e).
Përkujtues: Nëse jeni të martuar, **ju dhe bashkëshorti/ja juaj duhet** të nënshkruani faqen 7 të njoftimit të rinovimit.
- Hapi 6 Nëse nuk e keni zarfin tonë, dërgojeni me postë paketën te:

MAIL RENEWAL PROGRAM
HRA/MEDICAL ASSISTANCE PROGRAM
PO BOX 329060
BROOKLYN, NY 11232-9823

MOS HARRONI - Nëse nuk i ndiqni këto udhëzime, mbulimi juaj në Medicaid mund të mbarojë.

Nëse na i dërgoni dokumentet para datës që tregohet në formularin e Rinovimit, përfitimet tuaja aktuale mund të vazhdojnë të mbeten **të pandryshuara** deri në një njoftim të mëtejshëm.

SHËNIM:

- Nuk është e nevojshme të na dërgoni vërtetim të të ardhurave dhe burimeve, përveç nëse ju kërkohet në formularin e rinovimit. Shuma e të ardhurave që raportoni do të krahasohet me gjetjet në kompjuter. Nëse rezultatet e gjetjeve në kompjuter janë të ndryshme nga informacioni që ju na jepni, rezultatet e gjetura me kompjuter do të përdoren kur merret vendimi nëse ju kualifikoheni. Ju mund të na dërgoni vërtetim të të ardhurave dhe burimeve për t'u siguruar që ne kemi informacionin e duhur. Nëse zgjidhni të mos e dërgoni tani, mund t'ju kërkohet më vonë të na tregoni vërtetim të të ardhurave dhe/ose burimeve. Në tabelën mbrapa kësaj faqeje tregohet se çfarë mund të përdorni si vërtetim.
- Nëse sapo jeni transferuar nga New York City në një qark tjetër të New York State, por nuk keni një çështje Medicaid të hapur në vendin ku jetoni tani, duhet ta plotësoni dhe ta na e ktheni formularin e Rinovimit (MAP-909e). Ne do t'ju ndihmojmë që ta transferoni mbulimin tuaj.

DOKUMENTET PËR TË ARDHURAT DHE BURIMET: Të gjitha dokumentet për të ardhurat dhe burimet duhet të jenë aktuale. **Mos** dërgoni dokumente origjinale - vetëm kopje.

TË ARDHURAT: Llojet e zakonshme të të ardhurave dhe vërtetimet e mira për ato të ardhura përfshijnë:

Lloji i të ardhurave	Dokumentacion	Lloji i të ardhurave	Dokumentacion
Të ardhurat e fituara nga punëdhënësi	Çeqet/mandatpagesat ([4] katër javë me radhë) ose letër nga punëdhënësi	Kompensimi i punëtorit	Letra e shpërblimit ose mandatpagesë
Të ardhura nga vetëpunësimi	Kthimi i tatimit mbi të ardhurat aktual i nënshkruar dhe të gjitha skedulet e regjistrimeve të fitimeve dhe shpenzimeve	Përfitimet e veteranëve	Letër shpërblimi, mandatpagesë përfitimi ose korrespondencë nga Administrata e Veteranëve
Të ardhura nga qiraja e shtëpisë/dhomës	Letër nga qiraxhiu i dhomës, qiramarrësi ose mandatpagesë	Pagesë ushtarake	Letër shpërblimi ose mandatpagesë
Pagesë për ditët sëmurë në punë/të ardhura për aftësi të kufizuara	Letër shpërblimi/certifikatë, mandatpagesë përfitimi, ose korrespondencë nga burimi i të ardhurave	Interes/Dividentë/Honorare	Statement aktuale nga banka, unioni i kreditit ose institucioni financiar, letër nga brokeri, letër nga agjenti ose 1099 ose kthim tatimor (nëse nuk ka dokumentacion tjetër në dispozicion)
Përfitime për papunësi	Letër shpërblimi/certifikatë, statement e përfitimit mujor, korrespondencë nga Departamenti i Punës i NYS, printim i informacioneve të llogarisë së marrësit nga faqja e internetit e Departamentit të Punës të NYS (www.labor.state.ny.us), ose kopje e kartës Direct Payment me printim	Mbështetje nga pjesëtarët e familjes	Deklaratë e nënshkruar ose letër nga pjesëtari i familjes
Pensionet private/pensionet vjetore	Statement nga pensioni/pension vjetor	Të ardhura nga një Trust	Dokument i Trustit
Sigurimet Shoqërore	Letër shpërblimi/certifikatë, statement e përfitimit vjetor, ose korrespondencë nga Administrata e Sigurimeve Shoqërore	Ndihmë ekonomike/ushqimore për fëmijë	Letër nga personi që jep ndihmën ekonomike, letër nga gjykata, mandatpagesë e ndihmës ekonomike/ushqimore për fëmijë, kopje e NY Eppicard me printim, kopje e informacioneve të llogarisë së ndihmës ekonomike për fëmijë nga www.newyorkchildsupport.com , ose kopje e statement bankare ku tregohet depozita direkte

PUNËSIMI: Nëse jeni të regjistruar në programin Buy-In të Medicaid për Njerëzit që Punojnë me Aftësi të Kufizuara (MBI-WPD), duhet të na tregoni vërtetim të punësimit tuaj. Mund të na dërgoni një nga të mëposhtmet:

Deklaratë të detajuar me shkrim nga punëdhënësi	Formulari W-2
Çek/mandatpagesë aktuale	Kthimin e tatimit mbi të ardhurat

BURIMET: Burimet përfshijnë paratë në dorë, kursimet dhe llogaritë rrjedhëse, certifikatat e depozitës, aksionet, bondet, fondet trust, 401K, fondet e përbashkëta, zotërimi i një biznesi, prona që zotëroni ju ose dikush në familjen tuaj etj.

Vërtetime të pranueshme të burimeve përfshijnë:

Statement-e/llogaritë nga institucionet financiare në të cilat mbahen	Vlerësime/vlerësim i pasurive të paluajtshme
Kopje të policave/certifikatave	Kopje të kambialeve

MEDICARE PART C (Medicare Advantage Plan)/Sigurim Shëndetësor Privat: Nëse merrni mbulimin tuaj Medicare nëpërmjet një Medicare Advantage Plan, mund të keni të drejtën që kostoja e primeve të policës suaj të zbriten nga të ardhurat që buxhetojmë për të përcaktuar kualifikueshmërinë/vazhdimësinë e kualifikueshmërisë suaj. Ngaqë primet e planeve ndryshojnë, duhet të jepni vërtetim të kostove tuaja.

Kjo zbritje e të ardhurave mund të aplikohet gjithashtu për ju nëse i paguani punëdhënësit/sindikates ose një siguruesi të palës së tretë një prim të sigurimit tuaj shëndetësor.

Mund të na dërgoni një nga të mëposhtmet:

Faturë e paguar	Çek i anuluar ose "money order"
Kopje e statement bankare ku tregohet pagesa	Korrespondencë nga ofruesi i sigurimit ku tregohet pranimi (dhe shuma në dollarë) e pagesës së kryer të primit
Mandatpagesa që tregon zbritjen e pagesës për koston/pjesën tuaj të koston për mbulimin tuaj shëndetësor,	

A keni ndonjë problem të shëndetit mendor ose aftësi të kufizuar? A jua bën kjo gjendje të vështirë të kuptoni këtë njoftim se çfarë kërkohet në këtë njoftim? A jua bën kjo gjendje të vështirë që të merrni shërbime të tjera në HRA? **Ne mund t'ju ndihmojmë. Na telefononi në 888-692-6116. Gjithashtu mund të kërkoni ndihmë kur shkoni në një zyrë të HRA. Ju keni të drejtën sipas ligjit që të na kërkoni këtë ndihmë.**

KONSUMATORËT QË KANË PROBLEME ME DËGJIMIN QË PËRDORIN PAJISJE TELEFONIKE ME TEKST (TTY) MUND TË NA KONTAKTOJNË Ë 718-636-7783 OSE MUND TË TELEFONOJNË 711